



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra për Komunikim Publik/ Ured za Javno Komuniciranje/ Public Communication Office

RAPORT GJITHËPËRFSHIRËS
I
REALIZMIT TË SË DREJTËS PËR QASJE NE DOKUMENTE PUBLIKE
NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

RAPORTI VJETOR PËR VITIN 2017

Prishtinë, mars 2018

Përmbajtja

Faqe

1. Përmbledhje	4
2. E drejta e qasjes në dokumente publike	4
2.1 Parimet themelore.....	4
2.2 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Kosovë	4
3. Kërkesat për qasje në dokumente publike	5
3.1 Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës	5
3.1.1 Institucionet që nuk kanë dërguar raporte.....	5
3.2 Presidenca, Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese	6
3.2.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvend të Kosovës dhe Gjykatë Kushtetuese	6
3.3 Të dhënat e përgjithshme	9
3.3.1 Numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës	9
3.3.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në institucionet e Republikës së Kosovës	11
3.4 Qeveria e Republikës së Kosovës	13
3.4.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse ...	13
3.4.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse ...	17
3.5 Universitetet publike	21
3.5.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Universitetet publike	21
3.5.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Universitetet publike	21
3.6 Institucionet e Pavarura	24
3.6.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Institucionet e Pavarura	24
3.6.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Institucionet e Pavarura	26
3.7 Ndërmarrjet Publike	29
3.7.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Ndërmarrjet Publike	29
3.7.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Ndërmarrjet Publike	30
3.8 Komunitet e Republikës së Kosovës	32
3.8.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Komunitet e Republikës së Kosovës	32
3.8.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Komunitet e Republikës së Kosovës	33
4. Shtojcat	
4.1 Formulari i kërkesës për qasje në dokumente publike	37
4.2 Lista e kontakteve	38

HARTUES I RAPORTIT:

Arben Musliu, Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun

ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT

1. PËRMBLEDHJE

Në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Zyra për Komunikim me Publikun në Zyrën e Kryeministrit është e obliguar të mbledhë raportet nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe të përgatisë Raportin Vjetor Gjithëpërfshirës, për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike. Ky është raporti i shtatë të cilin e përgatiti Zyra për Komunikim me Publikun në Zyrën e Kryeministrit.

Nga raportet që janë dërguar nga të gjitha institucionet qendrore dhe lokale në Republikën e Kosovës, mund të konstatojmë se numri i kërkesave për qasje në dokumente publike ka shënuar rritje, po ashtu është vërejtur ngritje e kthimit të përgjigjeve pozitive dhe në afat sipas ligjit.

Në këtë Raport Gjithëpërfshirës janë prezantuar në formë tabelare dhe analizuar të gjitha të dhënat e dërguara nga institucionet qendrore dhe lokale. Poashtu, janë dhënë edhe profilet e kërkuësve dhe palëve të interesuara për qasje në dokumente publike, natyra e kërkesave dhe mënyra se si janë proceduar ato.

Zyra për Komunikim me Publikun e Zyrës së Kryeministrit duke parë nevojën për efikasitet më të madh të zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe sfidat me të cilat janë përballur zyrtarët dhe institucionet përkatëse ka qenë pjesë e procesit të hartimit të Projektligjit të ri për Qasje në Dokumente dhe Informacione Publike, i cili është finalizuar dhe pritet që të aprovohet nga Qeveria, për t'u proceduar për miratim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

2. E DREJTA E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE

2.1 Parimet themelore

E drejta për qasje në dokumente publike është kategori kushtetuese sipas nenit 41 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe hyn në kuadër të të drejtave dhe lirive themelore.

Në parim, sipas legjislacionit në fuqi, dokumentet e institucioneve publike janë të hapura për qasje të publikut, përveç në rastet kur është përcaktuar ndryshe me ligjet në fuqi.

E drejta e qasjes në dokumente publike është e ndërlidhur edhe me: lirinë e shprehjes, lirinë e mediave, lirinë e tubimit apo lirinë e asociimit.

2.2 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Kosovë

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në nenin 41,

"1. Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike."

"2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara."

- Ligji Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike

Ligji për Qasje në Dokumente Publike garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.

Në funksion të zbatimit me sukses të Ligjit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar:

1. Rregulloren nr. 04/2012 për evidencën zyrtare të kërkesave për qasje në dokumente publike;

2. Udhëzimin Administrativ nr.03/2011 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun ;
3. Rregulloren nr.02/2012/MF për tarifat në qasje në dokumente publike;
4. Udhëzimin Administrativ (MAP) nr.01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike;
5. Udhëzimin Administrativ nr.02/2011, për portalin qeveritar të Republikës së Kosovës;
6. Udhëzimin Administrativ nr.2008/09 për transparencën në komuna

- **Ligjet tjera të ndërlidhura**

1. Ligji nr.03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale;
2. Ligji nr.03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë;
3. Ligji nr.03/L-195 për Avokatit të Popullit;
4. Ligji nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative;
5. Ligji nr. 03/L-202 për konfliktet administrative;
6. Ligji nr. 04/L-184 për administrimin e punës në Zyrë

3. KËRKESAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

3.1 Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës

Pasqyra e përgjithshme e të dhënave për kërkesa për qasje në dokumente publike nga Institucionet e të gjitha niveleve që kanë obligim zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Tri institucionet e nivelit qendror janë paraqitur në fillim:

- Presidenca e Republikës së Kosovës
 - Kuvendi i Republikës së Kosovës
 - Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës
- Pastaj janë të prezantuara të dhënat e përgjithshme për Qeverinë, përfshirë Ministrinë dhe agjencitë vartëse, me gjithsejtë 83 institucione.
 - Të dhënat e institucioneve të pushtetit lokal, në 38 komuna të Kosovës.
 - Raportet nga pesë universitetet publike, 18 ndërmarrje publike dhe 27 institucione të pavarura, që janë të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

3.1.1 Institucionet që nuk kanë dërguar raporte

Prej të gjitha institucioneve që janë të obliguara të prezantojnë raportet e tyre sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, këtë vit raportet nuk i kanë dërguar 4 institucione të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe 5 komuna të Republikës së Kosovës:

- Institucioni i Avokatit të Popullit
- Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- Këshilli Prokurorial i Kosovës
- Komuna e Dragashit
- Komuna e Mitrovicës së Veriut
- Komuna e Ranillugut
- Komuna e Zveçanit
- Komuna e Zubin Potokut

3.2 Presidenca, Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese

3.2.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvend të Kosovës dhe Gjykatë Kushtetuese

Në vitin 2017, në këto tri institucione qendrore janë pranuar gjithsejtë 19 kërkesa.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të parashtruara në institucionet qendrore të Republikës së Kosovës

Tabela nr. 1:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Emri i institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e kufizuar	Totali
Presidenca e Republikës së Kosovës	10	0	0	10
Kuvendi i Republikës së Kosovës	4	0	0	4
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	5	0	0	5
	19	0	0	19

- Realizimi i qasjes në dokumente publike

Në vitin 2017, në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese, iu është lejuar qasje në 100 për qind të të gjitha kërkesave për qasje në dokumente publike.

Kjo është paraqitur edhe në grafikën në vijim:




Figura 1.

Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Presidencë, Kuvend dhe Gjykatë Kushtetuese

Kthimi i përgjigjeve sipas kërkesave

Tri institucionet qendrore, gjatë vitit 2017 kanë dërguar të gjitha përgjigjet në afatin e paraparë ligjor. Nuk ka pasur asnjë kërkesë që është refuzuar apo që ka marrë përgjigje të pjesshme.

- **Forma e kërkesave të pranuar dhe e përgjigjeve të dërguara**

Në Zyrën e Presidentit, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese, kërkesat kanë qenë të pranuar 84 për qind në formë elektronike dhe 16 për qind në kopje fizike.




Figura 2.
Forma e kërkesave të pranuar

Përgjigjet e dërguara nga këto tri institucione janë 68 për qind në mënyrë elektronike dhe 32 për qind në kopje fizike.




Figura 3.
Mënyra e dërgimit të përgjigjeve

- **Profili i kërkuesve të dokumenteve në Zyrën e Presidentit, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në Gjykatën Kushtetuese**

Gjatë vitit 2017, kërkuesit më të shpeshtë të dokumenteve kanë qenë gazetarët me 42 për qind, pasuar nga studentët me 21 për qind, nga 16 për qind kërkesat e parashtruara kanë qenë nga partitë politike dhe individë dhe me 5 për qind janë kërkesat nga shoqëria civile.




Figura 4.
Profili i kërkuarëve të dokumenteve

- Lloji i dokumenteve të kërkuara në Zyrën e Presidencës, në Kuvendin e Kosovës dhe në Gjykatën Kushtetuese

Gjatë vitit 2017, në Presidencë, në Kuvendin e Kosovës dhe në Gjykatën Kushtetuese, kërkesat e dërguara kanë qenë 29 për qind për vendime, 24 për qind në buxhet dhe shpenzime, 19 për qind në letërkëmbime dhe informata, 10 për qind në kontrata dhe nga 9 për qind në projektligje dhe statistika.




Figura 5.
Lloji i dokumenteve të kërkuara te institucionet qendrore

3.3 TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

3.3.1 Numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës

Tabela nr. 2:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2017 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjesshme	Totali
Institucionet qendrore; Presidenca, Kuvendi, Gjykata Kushtetuese	19	0	0	19
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencinë vartëse	1171	45	18	1234
Institucionet e Pavarura	175	7	9	191
Universitetet	85	0	6	91
Ndërmarrjet Publike	53	3	0	56
Komunat	894	35	4	933
Totali	2397	90	37	2524

Me qëllim të ofrimit të mundësisë së krahasimit, në vijim po japim tabelën nga raporti i realizimit të së drejtës për qasje në dokumente publike të viteve të kaluara

Tabela nr. 3:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2016 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjesshme	Totali
Institucionet qendrore; Presidenca, Kuvendi, Gjykata Kushtetuese	20	0	1	21
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencinë vartëse	599	31	41	671
Institucionet e Pavarura	173	5	3	181
Universitetet	87	2	0	89
Ndërmarrjet Publike	122	2	0	124
Komunat	1049	22	12	1083
	2050	62	57	2169

Tabela nr. 4:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2015 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjesshme	Totali
Institucionet qendrore; Presidenca Kuvendi, Gjykata Kushtetuese	22	2	2	26
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	785	69	33	887
Institucionet e Pavarura	205	13	1	219
Universitetet	75	0	0	75
Ndërmarrjet Publike	84	1	2	87
Komunat	789	31	18	838
Totali	1960	116	56	2132

Tabela nr. 5:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2014 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore; Presidenca, Kuvendi, Gjykata Kushtetuese	27	2	4	0	0	33
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	736	9	25	25	56	851
Institucionet e Pavarura	156	6	4	2	2	170
Universitetet	15	1	0	0	0	16
Ndërmarrjet Publike	59	0	0	0	0	59
Komunat	846	18	9	24	26	923
Totali	1866	36	38	50	83	2073

Tabela nr. 6:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2013 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore; Presidenca, Kuvendi, Gjykata Kushtetuese	26	2	1	0	0	29
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	1095	11	26	34	7	1173
Institucionet e Pavarura	156	6	4	2	2	170
Ndërmarrjet Publike	59	0	0	0	0	59
Komunat	497	18	19	28	6	568
Totali	1833	37	50	64	15	1999

Tabela nr. 7:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2012 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucionet / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore; Presidenca, Kuvendi, Gjykata Kushtetuese	45	1	/	/	/	47
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	540	52	8	/	15	615
Institucionet e Pavarura	79	4	1	/	2	86
Ndërmarrjet Publike	8	/	/	/	/	8
Komunat	530	36	8	/	14	588
	1202	93	17	/	31	1343

3.3.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në institucionet e Republikës së Kosovës

Nga të dhënat e paraqitura në formë tabelare, që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, shihet se numri i kërkesave për qasje ka shënuar rritje, krahas saj është shtuar edhe efikasiteti i institucioneve publike duke lejuar qasje të plotë në dokumentet publike të cilat i posedojnë. Që nga fillimi i zbatimit të Ligjit në vitin 2012, kur numri i kërkesave ka qenë gjithsejtë 1343, qasja e lejuar ka qenë për 1202 kërkesa apo 90 për qind, qasja e refuzuar 93 kërkesa apo 7 për qind, dhe të tjera 31 kërkesa apo 2 për qind. Ndërsa në vitin 2017, nga gjithsejtë 2524 kërkesa qasja e lejuar është 2397 apo 95 për qind, qasja e refuzuar dhe pa përgjigje është 90 apo 4 për qind dhe qasja e pjesëshme 37 apo 1 për qind.




Figura 6.

Realizimi i përgjithshëm i së drejtës për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës - krahasimi i viteve që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike

3.4 QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

3.4.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse

Numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike gjatë vitit 2017, në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ku përfshihen Zyra e Kryeministrit, ministrinë dhe agjencitë e tyre vartëse, pothuajse është dyfishuar. Gjatë vitit 2017, numrin më të madh të kërkesave e ka pasur Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare (ARBK) dhe Dogana e Kosovës.

Më poshtë është paraqitur tabela me të dhënat dhe numrin e kërkesave të parashtruara për qasje në dokumente publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministrinë dhe agjencitë vartëse. Në të gjitha tabelat ku janë të regjistruara numri i kërkesave të refuzuara dhe pa përgjigje, janë të përfshira në të njëjtën rubrikë, bazuar në nenin 10 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Tabela nr. 6:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministrinë dhe në agjencitë vartëse

	Emri i institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjesshme	Totali
1	Zyra e Kryeministrit	23	2	3	28
2	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>	20	0	0	20
3	<i>Agjencia për Barazi Gjinore</i>	0	0	0	0
4	<i>Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike</i>	0	0	0	0
5	<i>Këshilli Ndërministror për Ujëra</i>	0	0	0	0
6	<i>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë</i>	0	0	0	0
7	<i>Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore</i>	0	0	0	0
8	Ministria e Integritit Evropian	28	0	0	28
9	Ministria për Komunitete dhe Kthim	7	2	0	9
10	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	3	0	1	4
11	<i>Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës</i>	0	0	0	0
12	<i>Agjencia Kadastrale e Kosovës</i>	0	0	0	0

13	Ministria e Punëve të Brendshme	20	0	0	20
14	<i>Policia e Kosovës</i>	1	0	0	1
15	<i>Akademia e Kosovës për Siguri Publike</i>	0	0	0	0
16	<i>Agjencioni për Menaxhim Emergjent</i>	0	0	0	0
17	<i>Agjencioni për Regjistrim Civil</i>	0	0	0	0
18	<i>Inspektorati Policor i Kosovës</i>	0	0	1	1
19	<i>Agjencioni i Kosovës për Forenzikë</i>	0	0	0	0
20	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	2	0	0	2
21	Ministria e Administratës Publike	7	1	0	8
22	<i>Instituti i Kosovës për Administratë Publike</i>	0	0	0	0
23	<i>Agjencia e Shoqërisë së Informacionit</i>	0	0	0	0
24	Ministria e Infrastrukturës	17	0	0	17
25	<i>Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror</i>	2	0	0	2
26	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	1	10	2	13
27	<i>Instituti Pedagogjik</i>	0	0	0	0
28	<i>Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve</i>	0	0	0	0
29	<i>Qendra e Studentëve</i>	0	0	0	0
30	<i>Biblioteka Universitare</i>	0	0	0	0
31	<i>Agjencia e Kosovës për Akreditim</i>	0	0	0	0
32	<i>Agjencia për Aftësim Profesional dhe për të Rritur e Kosovës</i>	0	0	0	0
33	<i>Instituti Albanologjik i Prishtinës</i>	0	0	0	0
34	<i>Inspektorati i Arsimit në Republikën e Kosovës</i>	0	0	0	0
35	<i>Instituti i Historisë</i>	0	0	0	0
36	<i>Instituti i Lepasvitiqit</i>	0	0	0	0
37	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	7	0	1	8

38	Agjencioni Pyjor i Kosovës	0	0	0	0
39	Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë	0	0	0	0
40	Ministria e Drejtësisë	0	1	0	1
41	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar	0	0	0	0
42	Shërbimi Korrektues i Kosovës	0	0	0	0
43	Ministria e Financave	23	1	1	25
44	Administrata Tatimore e Kosovës	18	2	0	20
45	Dogana e Kosovës	345	1	0	346
46	Agjencioni Qendror i Prokurimit	0	0	0	0
47	Njësia e Inteligjencës Financiare	0	0	0	0
48	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	6	0	0	6
49	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	11	4	1	16
50	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	4	0	0	4
51	Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"	0	0	0	0
52	Teatri Kombëtar i Kosovës	0	0	0	0
53	Qendra Kinematografike e Kosovës	0	0	0	0
54	Galeria Kombëtare e Kosovës	0	0	0	0
55	Ansambli Kombëtar Shtetëror i Këngëve dhe Valleve "SHOTA"	0	0	0	0
56	Filarmonia e Kosovës	0	0	0	0
57	Kosovafilmi	0	0	0	0
58	Baleti i Kosovës	0	0	0	0
59	Muzeu i Kosovës	0	0	0	0
60	Instituti Arkeologjik i Kosovës	0	0	0	0
61	Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve	0	0	0	0
62	Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore	0	0	0	0

63	Ministria e Punëve të Jashtme	6	8	0	14
64	<i>Akademia diplomatike e Kosovës</i>	0	0	0	0
65	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	19	4	2	25
66	<i>Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës</i>	0	0	0	0
67	Ministria e Shëndetësisë	47	3	2	52
68	<i>Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës</i>	1	1	0	2
69	<i>Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale</i>	0	0	0	0
70	<i>Instituti i Kosovës për Shëndetësi Publike</i>	1	1	0	2
71	<i>Qendra Kombëtare për Transfuzion të Gjakut e Kosovës</i>	0	0	0	0
72	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	10	2	0	12
73	<i>Agjencia Kosovare e Standardizimit</i>	0	0	0	0
74	<i>Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare</i>	516	0	0	516
75	<i>Agjencia e Promovimit të Investimeve e Kosovës</i>	0	0	0	0
76	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës</i>	0	0	0	0
77	<i>Agjencia e Metrologjisë së Kosovës</i>	0	0	0	0
78	<i>Agjencia për Pronësi Industriale</i>	0	0	0	0
79	<i>Inspektorati i Tregut</i>				
80	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	14	2	4	20
81	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	12	0	0	12
82	Ministria e Zhvillimit Rajonal	0	0	0	0
83	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	0	0	0	0
		1171	45	18	1234

3.4.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministrinë dhe agjencitë e tyre vartëse

Në tabelën më poshtë janë të prezantuara numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministrinë dhe agjencitë e tyre vartëse, ku janë të përfshira edhe mënyra e trajtimit të kërkesave dhe ndarja në dy grupe e institucioneve.

Tabela nr 7.

Institucioni/ njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjesshme	Totali
ZKM dhe Ministrinë	263	40	17	320
Agjencitë e ZKM-së dhe të Ministrive	908	5	1	914
	1171	45	18	1234

Zyra e Kryeministrit dhe Ministrinë Agjencitë vartëse të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrive

Realizimi i qasjes në dokumente publike

Qeveria e Kosovës është përgjigjur në shumicën e kërkesave të pranuar, duke refuzuar dhe duke ju dhënë qasje të pjesshme një numri shumë të vogël të kërkesave.

Siç shihet në tabelën më poshtë, qasje e plotë iu është lejuar në 1171 kërkesa apo 95 për qind, janë refuzuar apo pa përgjigje 45 kërkesa apo 4 për qind dhe iu është dhënë qasje e pjesshme në 18 kërkesa apo 1 për qind të tyre.




Figura 7.
Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës

Refuzimet

Nga numri i kërkesave të refuzuara, prijnë kërkesat për politikat ekonomike me 37 për qind, pastaj interesat komerciale me 36 për qind, 18 për qind të dhënat personale dhe siguria kombëtare me 9 për qind.




Figura 8.
Numri i kërkesave të refuzuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Forma e kërkesave të pranuar dhe mënyra e dërgimit të përgjigjeve

Mënyra e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike, është bërë 54 për qind në formë elektronike, 45 për qind kopje fizike dhe në formë elektronike dhe kopje fizike 1 për qind e të gjitha kërkesave.




Figura 9.
Mënyra e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike

Qeveria e Republikës së Kosovës nga të gjitha kërkesat e pranuar, në formë elektronike iu është përgjigjur 52 për qind të kërkesave, ndërsa në kopje fizike 48 për qind të kërkesave.




Figura 10.
Mënyra e dërgimit të përgjigjeve për qasje në dokumente publike

Profili i aplikuesve

Për dallim prej viteve të kaluara kur me numër të kërkesave kanë dominuar gazetarët, gjatë vitit 2017 numri më i madh i kërkesave për qasje në dokumente publike janë parashtruar nga organizatat buxhetore me 45 për qind të kërkesave, gazetarët 28 për qind të kërkesave, shoqëria civile 11 për qind të kërkesave, që përbëjnë 84 për qind të të gjitha kërkesave, ndërsa 16 për qind janë të tjera, studentë, individë dhe parti politike.




Figura 11.
Profili i aplikuesve për qasje në dokumente publike

Dokumentet e kërkuara

Kontratat janë dokumentet më të kërkuara në Qeverinë e Republikës së Kosovës, me gjithsejtë 46 për qind, pastaj statistikat me 19 për qind, dhe pjesa tjetër janë raporte me 14 për qind, buxhet, shpenzime dhe vendime me 7 për qind, marrëveshje, projekte dhe konkurse me nga 2 për qind.




Figura 12.
Llojet e dokumenteve të kërkuara në Qeveri gjatë vitit 2017

3.5 UNIVERSITETET PUBLIKE

3.5.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Universitetet publike

Në universitetet publike gjatë vitit 2017, janë parashtruar gjithsejtë 91 kërkesa për qasje në dokumente publike. Nga të gjitha kërkesat e parashtruara qasje të lejuar kanë marrë 85 kërkesa apo 95 për qind, qasje të pjeshme 6 kërkesa apo 5 për qind e tyre dhe të refuzuara apo pa përgjigje asnjë.

Tabela nr 8:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në universitetet publike

Emri i Institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjeshme	Totali
1 Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"	61	0	3	64
2 Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"	17	0	1	18
3 Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"	3	0	0	3
4 Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka"	0	0	2	2
5 Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"	4	0	0	4
	85	0	6	91

3.6.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Universitetet publike

Realizimi i qasjes në dokumente publike

Gjatë vitit 2017, nga numri i përgjithshëm i kërkesave nuk ka asnjë kërkesë të refuzuar, të lejuara janë 95 për qind e kërkesave dhe 5 për qind e kërkesave kanë marrë qasje të pjeshme.




Figura 13.
Realizimi i qasjes në dokumente publike në universitetet publike

Forma e kërkesave të pranuar dhe e përgjigjeve të dërguara

Kërkesat për qasje në dokumente publike gjatë vitit 2017, tek universitet publike janë parashtruar 47 për qind në formë elektronike, 35 për qind në formë elektronike dhe kopje fizike dhe 18 për qind e tyre në kopje fizike.




Figura 14.
Forma e kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike

Përgjigjet që janë kthyer nga universitetet publike gjatë vitit 2017, 52 për qind në mënyrë elektronike, 24 për qind në mënyrë elektronike dhe kopje fizike, 23 në kopje fizike dhe vetëm 1 për qind në CD.




Figura 15.
Mënyra e dërgimit të përgjigjeve

Profili i aplikuesve

Numri më i madh i kërkesave për vitin 2017 tek universitetet publike, kanë qenë nga organizatat buxhetore me 38 për qind të të gjitha kërkesave, 17 për qind e kërkesave kanë ardhur nga individë, me nga 13 për qind gazetarë dhe organe inspektuese, 11 për qind studentë dhe 8 për qind e kërkesave nga shoqëria civile.




Figura 16.
Profili i kërkuarve të dokumenteve për qasje në dokumente publike, në universitetet publike

Dokumentet e kërkuara

Te universitetet publike gjatë vitit 2017 janë kërkuar këto lloj dokumentesh, 45 për qind vendime, 16 për qind konkurse, nga 12 për qind buxhet, shpenzime dhe procesverbale, 8 për qind kontrata, 5 për qind video incizime dhe 2 për qind e kërkesave projekte.




Figura 17.
Lloji i dokumenteve të kërkuara në universitetet publike

3.6 INSTITUCIONET E PAVARURA

3.6.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Institucionet e Pavarura

Nga 26 institucione të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që i dërgojnë raportet vjetore numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike, gjatë vitit 2017 ka qenë 191 kërkesa.

Tabela 9:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në institucionet e pavarura

	Emri i Institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjeshme	Totali
1	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	5	0	1	6
2	Komisioni i Pavarur i Mediave	5	0	0	5
3	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil	8	1	3	12
4	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	4	0	0	4
5	Banka Qendrore e Kosovës	6	0	2	8

6	Autoriteti i Aviacionit Civil	3	0	0	3
7	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	3	1	2	6
8	Agjencia Kosovare e Privatizimit	9	5	1	15
9	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	4	0	0	4
10	Zyra Kombëtare e Auditimit	1	0	0	1
11	Akademia e Drejtësisë	3	0	0	3
12	Zyra e Rregullatorit për Energji	1	0	0	1
13	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	0	0	0	0
14	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	5	0	0	5
15	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës	61	0	0	61
16	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	3	0	0	3
17	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1	0	0	1
